



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR  
Tiranë

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), si Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri, është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e gjithë veprimtarisë kombëtare të standardizimit, me qëllim plotësimin e nevojave të palëve të interesuara për standarde teknike për të gjitha fushat e ekonomisë.

**Misioni** i punës së veprimtarisë së standardizimit është të sigurojë plotësimin e nevojave të të gjitha palëve të interesuara (industria/biznesi, tregtia, autoritetet publike, ambientalistët, konsumatorët, SME-të, academia) për standarde teknike bashkëkohore në të gjitha fushat e ekonomisë, në mbështetje të konkurrueshmësisë dhe reduktimit të Barrierave Teknike në Tregti.

**Qëllimi** është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, kafshëve si dhe mjedisit.

Këto janë materializuar edhe ndërmjet qëllimit të programit 04160, i cili është: Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale

Për përmbushjen e sa më sipër, objektivat e DPS janë:

- Të përafrojë legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC).
- Të zbatojë dhe rishikojë të gjithë paketën ligjore për proceset e integritimit në fushën e standardizimit.
- Të organizojë dhe drejtojë punën për progresin në adaptimin e standardeve evropiane dhe informimin e ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë dhe palëve të interesuara për rëndësinë e standardeve
- Të mirëadministrojë Sistemin e Menaxhimit të Standardeve (SMS), shitjen e tyre dhe mirëfunksionimin e Autoritetit Kombëtar të Notifikimit dhe Pikës së Referimit në OBET dhe CEFTA.
- Të funksionojnë sa më mirë strukturat e DPS (Bordi Drejtues, Bordi Teknik dhe Komitete Teknike)

Nëpërmjet këtij relacioni, si dhe formateve bashkëlidhur, informojmë mbi objektivat, treguesit e performancës në nivel qëllimi, objektivi si dhe produktet e realizuara, në sasi e vlerë, për vitin 2021.

Produktet sipas Programit : Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale me kod 04160, janë Standarde evropiane dhe ndërkombëtare të adaptuara, miratuara si SSH si dhe Shitja e Standardeve.

**1. Adoptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH)**

Parashikimi për vitin 2021 ishte të adaptohen si SSH gjithsej **2,060** standarde sipas programit të punës së Drejtorisë së Standardeve. Në fakt janë adaptuar **2,225** standarde, me një realizim 108 %, të detajuara si në tabelën 1

Tabela 1 Adaptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si SSH për vitin 2021

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	Fakt	Realizimi në %
<b>1</b>	Standarde të adaptuara (CEN/CENELEC)	1200	1298	108 %
<b>2</b>	Standarde të ETSI	400	400	100 %
<b>3</b>	Standarde të ISO/IEC	460	527	114 %
	<b>Totali</b>	<b>2,060</b>	<b>2,225</b>	108 %

**2. Përafrimi i legjislacionit** kombëtar me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC). Objektivi është të zbatohet dhe rishikohet të gjithë paketën ligjore për proceset e integritimit në fushën e standardizimit. Në këtë kuadër punohet për evidentimin e të rejave sipas situatës në fushën e standardizimit.

### 3. Promovimi dhe publikimet

- Janë përgatitur gjithsej:

**29** Artikuj me titujt:

- Turizmi aventuror. Më shumë emocione dhe më pak rrisqe me standardet Ndërkombëtare
- Standardi Evropian (EN 16 372) mbi Shërbimet e Kirurgjisë Estetike
- Uji është jeta!
- Një standard i ri ndërkombëtar për të ulur aksidentet në miniera!
- Kërkesat e përgjithshme për kompetencën e laboratorëve të testimit dhe kalibrimit!
- Përdorimi i standardeve të Organizatës Ndërkombëtare të Standardizimit
- Të udhëtosh në periudhë pandemie - A do të rimëkëmbet ndonjëherë sektori i turizmit;
- Shërbim cilësor ndaj klientit - Me udhëzimet e reja Ndërkombëtare çdokush del i fituar;
- Sapo është publikuar nga ISO Standardi i Parë Ndërkombëtar, për mundësinë e të bërit turizëm nga të gjithë njerëzit;
- Fushata e vaksinave në të gjithë botën vë në qendër të vëmendjes edhe prodhimin e shiringave;
- Siguria dhe Shëndeti në Punë;
- Vende pune të përshtatshme gjatë periudhës së pandemisë COVID-19;
- Vula e re e sigurisë Evropiane të turizmit për Covid-19, nga Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN);
- Ndikimi dhe kontributi i standardeve në rritjen ekonomike;
- Festimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas;

- Qëllimet dhe prioritetet e Organizatës Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO), gjatë 10-vjeçarit të ardhshëm;
- Për parandalimin e krimit në zonat urbane (CPTED) nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin ISO;
- Sigurimi i jetesës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqënies për të gjitha grup moshat;
- 100 vjetori i krijimit të standardeve Italiane;
- Për reduktimin e ndotjes së mjedisit nga hidrokarburet nga Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN);
- Rëndësia e ndikimit të materialeve lidhur me efikasitetin e pajisjeve elektrike dhe elektronike: Seria e re e standardeve Evropiane;
- Testimi mjekësor laboratorik;
- Për matjen e lagështisë në erëzat dhe melmesat pikante nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO);
- Forumi ekonomik botëror thekson përfitimet e standardeve ISO dhe IEC me mjetet e reja rregullatore;
- Rritja e besimit tek rezultatet e testeve laboratorike të ushqimeve;
- Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO), sapo ka përditësuar standardet e reja në fushën e ergonomisë;
- Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO), sapo ka publikuar një seri të re standardesh për sigurinë e pasaportave biometrike;
- Peshkimi ekologjik, miqësor me mjedisin;
- Matjet laboratorike të zhurmave, që shkaktohen gjatë ecjes në dysheme është standardi më i ri i publikuar nga Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN);
- Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO), sapo ka përditësuar standardin për formatin PDF;
- E ardhmja e pasigurtë e kompanive të fluturimeve ajrore.

➤ **4 Buletinë të cilët janë:**

- Buletini Nr. 86;
- Buletini Nr. 87;
- Buletini Nr. 88;
- Buletini Nr. 89

- Notifikimet lidhur me reduktimin e barrierave teknike në tregti; OBT/CEFTA.
- Përditësimi i rubrikës dialog me palët.

➤ **Takime/Prezantime:**

- Nga Drejtoria e Standardeve janë realizuar 2 (dy) mbledhje të Bordit Teknik (BT) të DPS, 2 (dy) mbledhje të Bordit Drejtues (BT).
- Përditësimi i videove të animuara për cdo 2 javë i objektivave të DPS.

**Realizimi i Treguesve ekonomiko-financiare (Aneksi 2)**

Buxheti vjetor i akorduar për DPS, konsiston në mbështetjen logjistike të ushtrimit të kompetencave e funksioneve të institucionit, për arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjatë

vitit kemi pasur disa rialokime të fondeve buxhetore dhe buxheti vjetor i rishikuar i institucionit rezulton i alokuar për paga 50%, sigurime 9 %, shpenzime operative 6%, pagesë të kuotave ndërkombëtare 28%, dhe investime kapitale 7 % (Tabela 2).

Table 2 Plani buxhetor 2021 dhe % e zërave të shpenzimeve kundrejt totalit

**Në mijë lekë**

Nr.	EMËRTIMI	PLANI BUXHETOR 2021	NË % NDAJ TOTALIT
<b>1</b>	Paga	14.000	50 %
<b>2</b>	Sigurime shoqërore	2.500	9 %
<b>3</b>	Mallra e shërbime të tjera	1.752	6 %
<b>4</b>	Transferta Korente të Huaja	8.000	28 %
<b>5</b>	Transferta tek individët dhe familjet	123	0 %
<b>6</b>	Investime	1.579	7 %
	<b>Totali</b>	<b>27,954</b>	<b>100%</b>

Nga fondi i planifikuar për vitin 2021 prej **27,954 mijë lekë**, DPS ka shpenzuar **vlerën 27,160 mijë lekë**. Buxheti është realizuar në masën **97 %**, për vitin (tabela 3)

Duhet të vëmë në dukje se mosrealizimi në zërin e shpenzimeve korente për mallra dhe shërbime, ka ardhur si pasojë e situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia Covid 19, pasi janë ndërprerë udhëtimet e dietat jashtë vendit, për pjesëmarrje në aktivitete të organizatave ndërkombëtare të standardizimit.

**Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore (600-601)**, është realizuar për numrin faktik të punonjësve respektivisht në vlerën **13,995 mijë lekë** për paga ose pothuaj **100 %** e fondit të planifikuar të shpenzimeve si dhe **2,324 mijë lekë** për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore, ose **92%** të planit. Staf i DPS është i plotë me 14 nëpunës civilë, 1 punonjës administrativ dhe 1 punonjës me kontratë.

Në tabelën e mëposhtme, pasqyrohet realizimi në % dhe vlerë, i secilës kategori shpenzimesh, përkundrejt buxhetit të akorduar.

- **Fondi për Shpenzime Korrente të tjera (602-606)**, për vitin 2021 është realizuar në vlerën **1,848 mijë lekë**, nga **1,752 mijë lekë te planifikuara** ose rreth 105 % dmth është tejkualuar fondi i planifikuar tek 602, duke bërë rialokim fondesh brenda zërave të shpenzimeve operative në mënyrë që të kemi një përdorim sa më eficient të tyre. Ky fond është përdorur për:
  - Shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit, si detyrime energji elektrike, ujë, siguria objekti, shërbime bankare, postare e telefonike.
  - Shpenzime për transferta korrente të huaja, të cilat janë pagesa të kuotizacioneve të organizmave evropiane e ndërkombëtare, në të cilat DPS bën pjesë
  - Shpenzime korrente te tjera

Table 3 tabela e akordimit të fondeve buxhetore 8 mujori, 2021 dhe realizimi në vlerë dhe %

Në 000 / lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	FAKT	REALIZIMI NE %
1	Paga	14,000	13,995	99.9 %
2	Sigurime shoqërore	2,500	2,324	92 %
3	Mallra e shërbime të tjera	1,752	1,848	105 %
4	Transferta Korente të Huaja	8,000	7,972	99.6 %
5	Trans per Buxh. Fam. & Individ	123	40	32 %
6	Investime	1,579	1,200	100 %
	<b>Totali</b>	<b>27,954</b>	<b>27,160</b>	<b>97 %</b>

- **Fondi për shpenzime investime** (zëri 230, 231), ku vlera e planit vjetor të fondit të investimeve ishte 2,000 (në mijë) lekë, në fillim të vitit, por pas ndryshimeve të fondeve, në fund të vitit ky fond ishte 1,579 mijë lekë.

Në zbatim të planit për shpenzime dhe investime, DPS ka hartuar planin e prokurimeve, i cili për vitin 2021, përmban 2 procedura prokurimi (shpenzime kapitale), me objekt **“Blerje pajisje TIK” (hardware), të cilat prokurohen nga AKSHI** prokurime në vlerën **1,200,000 e realizuar 100% lekë dhe program financiar (soft ware)** në vlerën rreth **379,310** lekë, i cili nuk u realizua për shkak se nuk arritëm të bënim prokurimin pasi miratimi i AKSHI erdhi me vonesë dhe nuk patëm kohën e duhur për të nisur procedurat. **Në Aneksin nr. 3** është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) në zbatim të objektivave për vitin 2021.

- Produkti 1 Adoptimi i Standarteve CEN/CENELEC
- Produkti 2 Adoptimi i Standarteve ETSI
- Produkti 3 Adoptimi i Standarteve IEC/ISO
- Produkti 4 Standarte te shitura

➤ **Të ardhurat nga Shitja e standardeve**

Për 8 mujorin e vitit 2021 janë shitur gjithsej **1,303** standarde, dhe të ardhurat e realizuara në vlerë janë afersisht **2,821,070** lekë.



**ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"**

ne 000/leke

Emri i Grupit		Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit				Kodi i Grupit		4160	
Programet		Shpenzimet e MFE/DPS							
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor 2021	Fakti 2021	Diferenca	
Titulli	Emertimi	i vitit paraardhes Viti 2020	Viti 2020	Plan Fillestar Viti 2021	Plan i Rishikuar Viti 2021	Plani i Periudhes/progresiv	i Periudhes/progresiv		
0001	Programi 1	42,280	32,500	36,000	27,575	27,575	27,160	-415	
0002	Programi 2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
0003	Programi 3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
0004	Programi 4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
0005	Programi 5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	
.....	.....								
<b>Totali i Shpenzimeve te Ministrise</b>		<b>42,280</b>	<b>32,500</b>	<b>36,000</b>	<b>27,575</b>	<b>27,575</b>	<b>27,160</b>	<b>-415</b>	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit		0	0	0	0	0	0	0	
<b>Totali</b>		<b>42,280</b>	<b>32,500</b>	<b>36,000</b>	<b>27,575</b>	<b>27,575</b>	<b>27,160</b>	<b>-415</b>	

**ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"**

ne 000/leke

Emri i Grupit	Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit		Kodi i Grupit	10
Programi	Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale		Kodi i Programit	04160
Art.	Emertimi	(5) Buxheti 2021 Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti vjetor i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	14,000	13,995	-5
601	Sigurime Shoqërore	2,500	2,324	-176
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,752	1,628	-124
603	Subvencione	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	8,000	7,973	-27
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	123	40	-83
<b>Nen-Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>26,375</b>	<b>25,960</b>	<b>-415</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	379	0	-379
231	Kapitale të Trupëzuara	1,200	1,200	0
232	Transferta Kapitale	0	0	0
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>1,200</b>	<b>1,200</b>	<b>0</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	1,200	1,200	0
232	Transferta Kapitale	0	0	0
<b>Nen -Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>0</b>	<b>1,200</b>	<b>0</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,200.0</b>	<b>1,200.0</b>	<b>0.0</b>
<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti</b>		<b>0.0</b>	<b>0.0</b>	
<b>Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)</b>		<b>27,575</b>	<b>27,160</b>	<b>-415</b>



**ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"**

<b>Emri i Grupit</b>	MFE/Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit	<b>Kodi i Grupit</b>	<b>10</b>
<b>Programi</b>	Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale	<b>Kodi i Programit</b>	<b>04160</b>

ne 000/leke					I			II			III			IV	Luhatjet ne Koston per Njesi		
Kodi 91008AD	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njësia matese	Sasia Faktike (sipas vitit paraardhës) 2020	Shpenzimet (sipas vitit paraardhës) 2020	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhës) 2020	Sasia (sipas planit vjetor) 2021	Shpenzimet (sipas planit vjetor) 2021	Kosto per Njesi (sipas planit vjetor) 2021	Sasia (sipas planit te rishikuar vjetor)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar vjetor)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar vjetor)	Sasia Faktike (ne fund te vitit)	Shpenzimet Faktike (ne fund te vitit)	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit)	V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III
A	Adoptimi i Standarteve CEN/CENELEC	Numer	1,225	13,687	11	1,200	19,460	16	1,200	14,906	12	1,298	14,574	11	0	-5	-1
B	Adoptimi i Standarteve ETSI	Numer	500	5,586	11	400	5,254	13	400	4,024	10	400	3,963	10	-1	-3	0
C	Adoptimi i Standarteve IEC/ISO	Numer	517	1,810	4	460	8,300	18	460	6,357	14	427	6,510	15	12	-3	1
D	Standartet e shitura	Numer	1,229	6,704	5	612	2,987	5	612	2,288	4	1,303	2,113	2	-4	-3	-2
	<b>TOTALI</b>		<b>3,471</b>	<b>27,787</b>		<b>2,672</b>	<b>36,000</b>		<b>2,672</b>	<b>27,575</b>		<b>3,428</b>	<b>27,160</b>				



**ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"**

**Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)**

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2021	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-mujore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M100015	Rikonstruksion godine, zyra	2,000	2021	2021		1,200	1,200.00	1,200.00	100%	

**Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)**

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit viti _____	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente

Drejtuessi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Sekretari i Përgjithshëm	Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	